Kronikë

Tre të rinjtë kërcënojnë me armë një person në Shkodër, VIDEO nga momenti kur i shkojnë me kallashnikov në derën e shtëpisë! Vihen në pranga

Tre të rinj kanë rënë në pranga në Shkodër pasi kërcënuan me armë një person. Për motive të dobëta, Aleksander Prendi, 19 vjeç, Andrea Cara, 21 vjeç dhe Erjon Uka, 21 vjeç ishin duke kërcënuar një person, por policia ka ndërhyrë dhe ka bërë të mundur arrestimin e tyre.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
7 Shkurt, 14:28 | **Përditësimi: 7 Shkurt, 15:00**

SHKODËR- Një ngjarje kriminale u parandalua në Shkjezë të Vau Dejësit nga policia. Tre persona ranë në prangat, Aleksandër Prendi, 19 vjeç, Andrea Cara, 21 vjeç dhe Erjon Uka, 21 vjeç, të cilët kërcënuan të armatosur në derën e banesës një tjetër person për motive të dobëta.

Kamerat e sigurisë kanë filmuar momentin kur një prej të rinjve me kallashnikov në dorë i afrohet personit që kërcënuan në derën e shtëpisë, i arrestuar tashmë nga policia. Si rezultat i operacionit "Shkjeza" u sekuestruan 2 armë, kallashnikovë dhe pushkë, me municion luftarak, një automjet dhe 3 aparate celular.

LEXO EDHE:
VIDEO-LAJM/ Thethi i mbuluar nga dëbora, temperaturat ekstreme arrijnë deri në -21 gradë

Në vijim të këtij operacioni u bë e mundur zbardhja dhe dokumentimi ligjor i dy rasteve të djegies së 4 automjeve, ngjarje të ndodhura në 18 nëntor 2022, në fshatin Mjedë, kanë djegur 3 të tilla, ndërsa në datën 10 janar 2023, në fshatin Kaçë, kanë djegur 1 tjetër.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprime të mëtejshme.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 14:42

Kërcënuan një person në Shkodër, shihni VIDEO-n kur i riu i shkon me kallashnikov tek dera e shtëpisë

Tre të rinj ranë në pranga në Shkodër pasi kërcënuan me armë një person në Shkodër. Në video shihet momenti kur një prej të rinjve shfaqet me kallashnikov në dorë në shtëpinë e personit që kërcënuan. Por falë ndërhyrjes së Policisë u parandalua një ngjarje e mundshme kriminale.

SI.E./KT/Shqiptarja.com

TAG: Erjon Uka | Andrea Cara | Aleksander Prendi | Shkodër

Komento

Komente

Agjenti: 07/02/2023 17:47

Ncncnc si me qene Afganistan qe levizin me kallash krah qafe

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A është i drejtë vendimi për të shtyrë Komisionin Hetimor për 'McGonigal'?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

U kap me 48 mijë euro të padeklaruara në pikën kufitare të Muriqanit, nën hetim 35-vjeçarit! I kishte fshehur në autobusin që drejtonte
7 Shkurt, 09:30

Rama ndan video nga Puka e mbuluar me dëborë: Mali i Krrabit ndër destinacionet më të preferuara në dimër
5 Shkurt, 11:15

Zëri i Amerikës: Ritme të ulëta zhvillimi në qarqet veriore të Shqipërisë
4 Shkurt, 22:44

FOTOLAJM/ Me familjen Malësi të Madhe, Rama ikën nga zhurma e 'Tiranës politike', poston foton mes borës
4 Shkurt, 18:01

Rritje të rasteve me grip në Shkodër, 2 mijë të sëmurë vetëm në janar! Epidemiologia: Simptoma të ngjashme me COVID-19, zgjat rreth 10 ditë

Ergys Kavaja

4 Shkurt, 16:09

Po transportonin 16 emigrantë të paligjshëm drejt Malit të Zi, arrestohet 42-vjeçari në Shkodër! Në kërkim 2 bashkëpunëtorët e tij
4 Shkurt, 11:11

Shembja e mbikalimit në Shkodër, ministrja Bilali: U dëmtua nga një goditje, njësi sociale na kanë kthyer në 'gjykatës tastierash'
4 Shkurt, 11:08

Emigrimi, Ipeshkvi i Shkodrës: Qeveria të garantojë jetë cilësore për shqiptarët që të mos heqin dorë nga atdheu
3 Shkurt, 17:23

VIDEO/ Kamioni që transportonte eskavatorin përplaset me mbikalimin në Shkodër! Bllokohet ruga në lagjen 'Bahçallëk', arrestohet shoferi 60 vjeçar
3 Shkurt, 12:08

Me pistoletë brenda në restorant, policia arreston 47 vjeçarin e përfshirë në krimin e organizuar në Shkodër! Tentoi të arratisej me vrap (EMRI)
2 Shkurt, 15:54

'Aralicën nuk e llogaris më në ekip', Mirel Josa: Vllaznia është pretendente
2 Shkurt, 14:01

Shkodër/ Kishin shkuar për ski në Razëm dhe mbetën të bllokuar, shpëtohen nga policia 5 të rinjtë
1 Shkurt, 17:47

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje